



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.10.2022

**RELACION**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 242, DATË 23.09.2022, TË BORDIT  
TË ERE-S, “MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PREJ 42 LEKË/KWH PËR KONSUMIN MBI 800 KWH/MUAJ  
PËR KLIJNTËT FAMILJARË PËR PERIUJHËN  
1 TETOR – 31 DHJETOR 2022”**

**Tiranë**

Të Nderuar anëtarë të Bordit,

Shoqëria FSHU sha ka përcjellë në ERE shkresën nr 7086/1 prot date 06.10.2022 ne te cilen ka bere me dije kostot qe duhen te perfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë elektrike për klientët familjarë për Muajin Tetor 2022.

Në këtë shkresë FSHU sh.a. është shprehur se ne kushtet kur nga organet vendimmarrese te Korporates Elektroenergjitike Shqiptare (KESH SH.A) është vendosur pezullimi i aplikimit te tarifave te shitjes se energjise elektrike per FSHU SH.A te miratuara me Vendimin e Keshillit Mbikqyres Nr.07, date 07.09.2022 per muajin Tetor 2022, duke u lene ne fuqi i njejti çmim të shitjes se energjise per konsumatoret familjare (pavarsisht konsumit) prej 2.6 lek/kWh, kostot e blerjes se energjise elektrike nga FSHU SH.A per kete kategori konsumatoresh per muajin Tetor 2022 ngelen te pandryshuara.

Shoqëria FSHU sh.a. ka kërkuar nga ERE vleresimin e situates se mesiperme ne lidhje me zbatimin Vendimit Nr.242, date 23.09.2022 te Entit Rregulltor te Energjise per aplikimin e çmimit te energjise te klienteve familjare per konsumin mbi 800 kWh.

Bashkëlidhur shkresës sipërcituar FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE dhe shkresën nr. 4820/6 prot., datë 05.10.2022, të KESH sh.a. si dhe Vendimin nr. 10, datë 04.10.2022 të Këshillit Mbikqyrës të KESH sh.a. “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a për muajin Tetor 2022”, Vendimin nr. 6490/5 prot., datë

05.10.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. për muajin tetor 2022” bashkë me relacionin shpjegues mbi të cilin janë mbështetur këto vendime.

Vendimmarrjet e sipërcituara kanë miratuar pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. miratuar me anë të vendimit nr.6645/1, datë 08.09.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit për muajin Tetor 2022.

Vendimi nr 10 date 04.10.2022 i Këshillit Mbikqyrës të KESH sh.a. “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a për muajin Tetor 2022”, ka vendosur tarifimin për shitjen e energjise elektrise per muajin Tetor 2022 sipas tabelës me poshte:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi është vendosur se tarifimi për shitjen e energjisë për FSHU për periudhën 01.11.2022 – 31.12.2022 të jetë si miratuar në vendimin e nr. 6645/1, datë 08.09.2022 të Asamblesë së përgjithshme të KESH sh.a..

ERE me anë të shkresës nr. 1758, datë 04.10.2022 ka kërkuar informacion ndaj KESH sh.a. të dhëna për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së FSHU sh.a. për periudhën Tetor - Dhjetor 2022 për energjinë mbi 800 kWh në muaj.

Në relacionin shpjegues të KESH sh.a. mbi të cilën janë mbështetur vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionartit dhe Këshillit Mbikqyrës të KESH sh.a., konstatohet ndër të tjera se përmirësimi i situatës hidrologjike në kaskadën e lumit Drin si dhe rënia konsumit të energjisë elektrike të klientëve të cilët shërbehen nga FSHU sh.a. në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, ka bërë të mundur mos ekspozimin e KESH sh.a. në blerjen e energjisë elektrike në tregun e lirë. Diferenca në kërkesën e FSHU lidhet me uljen e kërkesës për energji për TU si dhe uljen e kërkesës për rikthim të energjisë për humbjet në rrjet.

Në përfundim Shoqëria deklaron se në kuader të perditesimit periodik të situatës hidrike dhe aktivitetit do të perditesojë brenda datës 25 Tetor 2022, Këshillin Mbiqyres dhe Asamblenë e aksionareve për të dhënat financiare dhe energjetike, me qëllimin e paraqitjes së situatës dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për aplikimin e tarifimeve.

Në kushtet kur kostot e blerjes së energjisë elektrike për muajin Tetor 2022 nga ana e FSHU sh.a. janë të njëjta me kostot e blerjes së energjisë përpara marrjes së vendimit të bordit të ERE-s Nr. 242, Datë 23.09.2022 MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SH.A., LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERJISË PËR KLIENTËT FAMILJARË ME KONSUM MBI 800 KWH NË MUAJ”, vlerësojmë se, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga FSHU sh.a. për muajin Tetor 2022 të vijojnë të jenë ato të miratuar në vendimin nr. 74/2022 të Bordit të ERE.

Gjendur në këto rrethana, meqënëse ekzistojnë mundësitë e rivlerësimit të këtij çmimi përsëri nga KESH sh.a. bazuar në përmirësimin e treguesve tekniko ekonomik sikurse ndodhur së fundmi për muajin Tetor 2022, në rastin se kosto e blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a. në zbatim të VKM 456/2022 do të vijojë të jetë ajo e miratuar nga Asembleja e Përgjithshme e Aksionartit të KESH sh.a. prej 2.6 lekë/kwh për të gjithë konsumatorët të cilët shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, do të jetë e nevojshme që ERE të vijojë përsëri me ndryshimin e vendimit nr. 242, datë 23.09.2022, “Mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor 2022”, duke lënë në fuqi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike të miratuara me anë të vendimit nr. 74/2022 të Bordit të ERE.

**Për gjithë sa më sipër, si dhe në mbështetje të neneve 1, 83, 85 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 90 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; neni 12 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 08.10.2021 i ndryshuar “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, e ndryshuar; VKM-s nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neni 7, pika “g” të “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, miratuar me vendim të bordit të**

**ERE-s nr. .189, datë 23.11.2017 si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.06.2016, i propozojmë Bordit të ERE-s:**

- 1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 242, datë 23.09.2022 si më poshtë:**

*“Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjar për periudhën 1 Nëntor – 31 Dhjetor 2022.”*

- 2. Lënien në fuqi të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike të FSHU sh.a. të miratuara me anë të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, për muajin Tetor 2022. (Tabela bashkëlidhur).**